

NOA SH.A.

**PASQYRAT FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017
(ME RAPORTIN E AUDITUESIT TE PAVARUR)**

Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Flukseve të Parasë	3
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	4
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare	5 – 36



KPMG Albania Shpk
Deshmoret e Kombit Blvd
Twin Towers Building 1, floor 13
Tirana, Albania
+355 (4) 2274 524
al-office@kpmg.com
kpmg.com/al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Aksionarët e NOA SH.A.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NOA SH.A. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në raportin vjetor, i përgatitur nga drejtimi. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Fatos Beqja
Auditues Ligjor
KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 4 prill 2018

NOA SH.A.

Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Shumat në mijë Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivitet			
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	16	272,646	296,217
Hua institucioneve financiare	17	40,664	70,014
Hua dhe paradhënie klientëve	18	3,990,359	3,839,702
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	19	27,079	35,902
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	20	20,543	31,588
Aktive të shtyra tatimore	21	9,498	9,859
Aktive të tjera	22	31,687	39,444
Totali i aktiveve		4,392,476	4,322,726
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrimet			
Hua	23	3,213,733	3,291,165
Obligacione të emetuara	24	81,867	-
Grante	25	2,996	8,146
Tatim fitimi i pagueshëm	15	1,423	12,857
Detyrime të tjera	26	71,169	68,707
		3,371,188	3,380,875
Kapitali			
Kapitali i paguar	27	731,839	731,839
Rezerva ligjore	28	20,207	13,357
Fitime të mbartura		269,242	196,655
		1,021,288	941,851
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		4,392,476	4,322,726

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitur nga faqja 5 deri në faqen 36 dhe që janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare.

NOA SH.A.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

(Shumat në mijë Lek)

	Shënime	Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
		2017	2016
Të ardhura nga interesat	8	883,646	900,497
Shpenzime për interesa	9	(277,235)	(292,498)
Të ardhura neto nga interesat		606,411	607,999
Tarifa dhe komisione, neto	10	114,915	106,775
Rimarrjet nga kreditë dhe paradhëniet e fshira	11	172,339	144,888
Të ardhura të tjera	12	16,746	7,296
Të ardhura totale jo nga interesi		304,000	258,959
Shpenzime zhvlerësimi	19	(16,026)	(15,354)
Shpenzime amortizimi	20	(11,363)	(13,930)
Shpenzime personeli	13	(327,800)	(332,604)
Humbje neto nga provizioni i huave dhe paradhëniet për klientët	18	(164,777)	(148,763)
Shpenzime të tjera	14	(212,785)	(191,977)
Humbja neto nga kursi i këmbimit		(1,104)	(580)
Shpenzime totale operative		(733,855)	(703,208)
Fitimi para tatimit		176,556	163,750
Tatimi mbi fitimin	15	(29,060)	(26,748)
Fitimi për vitin		147,496	137,002
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		147,496	137,002

Pasqyra e e fitim humbje dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 36 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NOA SH.A.

Pasqyra e Flukseve të Parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(Shumat në mijë Lek)

	Shënime	2017	2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative:			
Fitimi per vitin		147,496	137,002
<i>Rregullimet për</i>			
Shpenzime zhvlerësimi	19	16,026	15,354
Shpenzime amortizimi	20	11,363	13,930
Humbje nga nxjerrja nga përdorimi i aktiveve		750	3
Humbje nga provizioni i huave ndaj klientëve	18	164,777	148,763
Rimarrje nga çështja gjyqësore për tatimin mbi fitimin	12	(9,381)	-
Amortizimi i granteve	12	(5,288)	(4,974)
Të ardhura nga interesat	8	(883,646)	(900,497)
Shpenzime per interesa	9	277,235	292,498
Shpenzime për tatim fitimin	15	29,060	26,748
<i>Ndryshime në</i>			
Hua dhe paradhënie klientëve		(311,509)	(238,943)
Kredi institucioneve financiare		28,636	(51,340)
Aktive të tjera		3,785	19,878
Detyrime të tjera		2,462	(1,906)
		(528,234)	(543,484)
Interes i arkëtuar		879,007	902,630
Interes i paguar		(270,101)	(292,324)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(30,618)	(13,891)
Mjetet e monetare neto të përdorura në aktivitetet operative		50,054	52,931
Flukset e parasë nga aktivitete investuese:			
Blerje të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	19	(7,953)	(11,506)
Blerje të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	20	(318)	(27,187)
Mjete monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(8,271)	(38,693)
Flukset e Parasë nga aktivitete financuese:			
(Pagesa)/hyrje nga huatë		(77,432)	115,275
Hyrje nga emetimi i obligacioneve	24	80,000	-
Hyrje nga grantet	25	138	485
Dividendë të paguar	27	(68,060)	(65,865)
Mjete monetare neto (të përdorura)/ nga aktivitetet financuese		(65,354)	49,895
(Rënie)/rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to		(23,571)	64,133
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës	16	296,217	232,084
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës	15	272,646	296,217

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 36 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NOA SH.A.


Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

(Shumat në mijë Lek)


	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitimet e mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	731,839	6,767	132,108	870,714
Fitimi për periudhën	-	-	137,002	137,002
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	137,002	137,002
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Transferim i fitimit të mbartur në rezervën ligjore	-	6,590	(6,590)	-
Dividendë	-	-	(65,865)	(65,865)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	6,590	(72,455)	(65,865)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	731,839	13,357	196,655	941,851
Fitimi	-	-	147,496	147,496
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	147,496	147,496
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Transferim i fitimit të mbartur në rezervën ligjore	-	6,850	(6,850)	-
Dividendë	-	-	(68,060)	(68,060)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	6,850	(74,910)	(68,060)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	731,839	20,207	269,241	1,021,287

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 36 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Drejtimi i Shoqërisë ka autorizuar këto pasqyra financiare më 4 prill 2018 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


Herjola Spahu

Drejtor Ekzekutiv


Ariola Cela

Drejtor i Financës

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

NOA SH.A (referuar si “NOA” ose “Shoqëria”), është një shoqëri aksionare shqiptare e vendosur në Tiranë, e cila vepron në fushën e mikro-kredisë për individë dhe Shoqëri të vogla dhe të mesme. Ka filluar aktivitetin e saj në 1999 si PSHM (Partneri Shqiptar në Mikrokredi) dhe më vonë si Opportunity Albania, në 2010 aksionet e Shoqërisë u blenë nga NOA Holdings N.V, një entitet i huaj i themeluar në Holandë. Shoqëria mëmë përfundimtare është Amryta Capital LLP me bazë në Londër (referojuni edhe shënimit 31). Në 2011 emri i shoqërisë u ndryshua nga Opportunity Albania në NOA SH.A.

Në 31 Dhjetor 2017, struktura e aksionerëve të NOA SH.A. është si më poshtë:

- NOA Holding N.V. 99.99%
- NOA Cooperatief U.A. 0.01%

NOA SH.A. udhëhiqet nga Këshilli Administrativ dhe Drejtimi Ekzekutiv i Shoqërisë. Këshilli Administrativ përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilat 4 janë të pavarur dhe nuk janë të lidhur me interesat dhe aktivitetin e Shoqërisë.

Anëtarë të Këshillit Administrativ në datën e raportimit janë:

Andrew Walsh, Kryetari i Këshillit
Herjola Spahiu, Zv / Kryetar
Tomas Hlavac, Anëtar
Elona Gjika, Anëtar
Anne Hodaj, Anëtar

Drejtimi Ekzekutiv përbëhet nga Administratorët e Shoqërisë.

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria operon më 26 pika shitje (2016: 21) të vendosura në të gjithë vendin duke ofruar shërbimet e saj përmes 282 punonjësve (2016: 311 punonjës).

2. Bazat kontabël

Këto Pasqyra Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë janë të përfshira në Shënimin 4.

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lek-un Shqiptar (“LEK”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha shifrat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur shprehet ndryshe.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, përveç kapitalit, që maten me kosto historike konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, përveç kapitalit, që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat që vijnë nga konvertimet njihen në humbje ose fitim.

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në humbje ose fitim bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivitet ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme gjatë një periudhe më të shkurtër kohore) deri në vlerën kontabël të aktivitet ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit është vendosur gjatë njohjes për herë të parë të aktivitet financiar dhe mund të rishikohet bazuar në termat e marrëveshjes. Norma efektive e interesit për detyrimet financiare vendoset gjatë njohjes për herë të parë të detyrimit dhe rishikohet më vonë bazuar në termat e marrëveshjes.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet dhe pikët e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, dhe zbritjet apo primet që janë pjesë e rëndësishme përbërëse e interesit efektiv. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i takojnë drejtpërdrejt blerjes, nxjerrjes ose shitjes së aktivitet ose detyrimit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje ose fitim përfshijnë interesin nga aktivitet dhe detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

(d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet vijnë nga shërbimet financiare që ofrohen nga Shoqëria. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në momentin që ofrohet shërbimi. Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Kur angazhimi për një hua nuk pritët të rezultojë në tërheqje të huasë, tarifat e komisionit njihen në mënyrë lineare gjatë periudhës së marrëveshjes. Shpenzime të tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me tarifat e transaksioneve dhe shërbimeve. Këto tarifa shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(e) Pagesat për qiratë

Pagesat e kryera për qiratë operative njihen në humbje ose fitim gjatë periudhës së qirasë sipas metodës lineare. Nxitësit e qirasë së marrë njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit të qirasë përgjatë jetëgjatësisë së saj.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në humbje ose fitim përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe penalitetet që lidhen me tatimin mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, trajtohen sipas SNK 37 *Provizionet, Detyrimet dhe aktivet e Kushtëzuara*.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin ose humbjen e tatueshme të vitit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose të merret që reflekton pasigurinë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ai matet duke përdorur normat e taksave të miratuara ose të miratuara në mënyrë substanciale në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale janë kompensuar vetëm nëse plotësohen disa kriteret

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet lidhur me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimi..

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjen tatimore të papërdorur, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen në bazë të planeve të biznesit. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që të realizohet përfitimi fiskal; Këto zvogëlime rimerren, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tatimor përmirësohet.

Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen për aq sa është e mundur që përfitimi tatimor të realizohet. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivitet tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyre vetëm në qoftë se kriteret e caktuara përmbushen.

(g) Aktivitet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Shoqëria fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën e tregtimit, në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar është matur fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tyre. Kostot e transaksionit për ato instrumente, që në vazhdim vlerësohen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes nuk përfshihen në vlerën me të cilën instrumenti njihet në fillim, por ngarkohen menjëherë në fitim ose humbje.

(ii) Klasifikimi

Referohuni politikave kontabël 4(g), (h), (i) dhe (n).

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Ç'rregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo i transferon të drejtën kontraktuale për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivi financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet e pronësisë së aktivit financiar. Interesi nga aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria nuk njeh një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Shoqëria merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një përqindje totale aktuale të shkëmbimit të kthimit mbi aktivet e transferuara, transaksioni llogaritet si një transaksion financiar i siguruar i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Në disa transaksione të caktuara ku Shoqëria as nuk ruan dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, ajo nuk e c'rregjistron aktivin nëse e humbet kontrollin mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet e ruajtura gjatë transferimit njihen më vete sipas rastit si aktive ose detyrime. Në transferime ku kontrolli mbi aktivin ruhet, Shoqëria vazhdon të njohë aktivin sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme të saj në aktivin financiar, e përcaktuar kjo nga masa e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

(iv) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera e tyre paraqitet neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm, dhe vetëm, nëse Shoqëria ka të drejtë ligjore t'i kompensojë dhe ka qëllim që të shlyejë në baza neto ose të fitojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në baza neto vetëm kur kjo lejohet nga standardet e kontabilitetit ose kur ato shkaktohen nga një grup i ngjashëm transaksionesh si për shembull nga aktiviteti i Shoqërisë.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo difference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt provizionit.

(vi) Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut në princip në datën e matjes, ose në mungesë të saj, tregu më i favorshëm për të cilin Shoqëria ka qasje në këtë datë. Vlera e drejtë e një aktivi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit. Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për një aktiv ose detyrim ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion të çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të marrin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni..

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja me vlerën e drejtë (vazhdim)

Treguesi më i mirë i vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të arkëtuar. Nëse Shoqëria përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk përcaktohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të ngjashëm dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna të njohura në tregje, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, dhe rregullohet për diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Në vijim, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave siç duhet gjatë kohëzgjatjes së instrumentit, por jo më vonë se periudha kur vlerësimi është plotësisht i mbështetur me të dhëna të njohura në treg ose kur mbyllet transaksioni.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka evidence objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse evidence objektive tregon se një ngjarje humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe që kjo ngjarje ka ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Të dhënat objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuar, mund të përfshijnë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një huaje me kushte dhe afate të cilat Shoqëria nuk do t'i kishte dhënë ndryshe, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me mospagesa të grupit.

Shoqëria konsideron evidencën e zhvlerësimit si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Huatë në nivel kolektiv zhvlerësohen duke grupuar së bashku huamarrësit që kanë karakteristika të ngjashme krediti. Huatë të cilat zhvlerësohen në mënyrë individuale identifikohen duke u bazuar në evidence objektive që niveli i tyre i rrezikut të kalojë nivelin historik të rrezikut të huave si për shembull rastet e ristrukturimit, humbjeve, kushteve të përkeqësuar ekonomike dhe delinkuencës prej më shumë se 90 ditësh për një huamarrës të vetëm i cili nuk ka të ardhura të evidentuara.

Për vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor modele statistikore të përvojës historike të humbjes, periudhën e rimarrjes dhe vlerën e humbjes. Vlerësimi i zhvlerësimit individual bazohet në kolateralin e vendosur për huanë, evidencat e flukseve të parasë për shlyerjen e huasë, gjykimit të manaxhimit mbi kushtet aktuale ekonomike, nëse ka, dhe klasifikimit të huave të portofolit. Drejtimi beson se fondet e zhvlerësimit janë të përshtatshme për humbjet nga huatë përbërëse të portofolit. Zhvlerësimi i huave ngarkohet kundrejt të ardhurave dhe zbritet nga shuma totale e humbjeve.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar llogariten si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar. Humbjet njihen në humbje ose fitim dhe pasqyrohen në një llogari zhvlerësimi përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit tregon për zvogëlim të humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Shoqëria fshin ato hua dhe paradhënie të klientëve të cilat janë përcaktuar si të pa-arkëtueshme (shiko shënimin 5).

(ii) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në banka dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënëse ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e amortizuar.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(iii) Hua dhe paradhënie

Huatë dhe paradhëniet janë aktive finaciare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Shoqëria nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në një periudhë afatshkurtër. Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(j) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambjentit ku ato janë vendosur. Kur pjesë të ndryshme të një aktiviteti të qëndrueshëm të trupëzuar kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (pjesët kryesore të tyre).

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihen në humbje ose fitim në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në humbje ose fitim në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo zëri të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Aktivitetet e marra me qira zhvlerësohen gjatë periudhës më të shkurtër ndërmjet kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Jeta e dobishme për vitin aktual dhe paraardhës është si më poshtë:

Pajisje elektronike	4 vite
Automjete	4 vite
Pajisje dhe mobilje	5 vite
Përmirësime të ambienteve të marra me qira	4 vite

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

(k) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Programet kompjuterike dhe licensat e blera nga Shoqëria njihen me koston historike të zvogëluar me amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Shpenzime vijuese për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime ndikojnë në rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të aktivitetit të cilit i ngarkohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Amortizimi njihet në humbje ose fitim në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të programit kompjuterik duke filluar nga data në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është 4 vjet.

(l) Inventari

Aktivitetet e tjera janë të përbëra nga aktivitetet e marra në zotërim nëpërmjet procesit të arkëtimit të huave me probleme, që nuk fitojnë qera, dhe nuk përdoren nga Shoqëria dhe kanë si qëllim shitjen në një kohë të shkurtër pa nevojën e një ristrukturimi të rëndësishëm. Aktivitetet e marra në zotërim maten me vlerën më të vogël ndërmjet koston dhe vlerës së realizueshme neto dhe cdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshem i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje ose fitim.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të pasasë dhe risqet specifike për aktivin.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për evidenca nëse humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël, që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(n) Huatë

Huatë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Huamarrjet përmbajnë kushte, të cilat nëse tejkalohe, i bëjnë huamarrjet të ripagueshme sipas kërkesës dhe të klasifikuara si detyrime afatshkurtra.

(o) Obligacionet e emetuara

Obligacionet e emetuara fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot shtesë të drejtperdrejta të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(p) Grantet

Një grant njihet fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar si e ardhur e shtyrë kur ka siguri të arsyeshme se ai do të arkëtohet dhe Shoqëria do të jetë në pajtueshmëri me kushtet e bashkëngjitura me grantin. Grantet e huasë të cilat përdoren për qëllime huaje me kushte specifike njihen në të ardhura në mënyrë lineare gjatë periudhës deri kur kushtet përmbushen. Grantet që kompensojnë Shoqërinë për shpenzimet e bëra njihen në të ardhura në të njejtën periudhë kur kryet shpenzimi përkatës. Grantet që kompensojnë Shoqërinë për koston e një aktivi njihen në të ardhura në mënyrë sistematike gjatë jetës së dobishme të aktivit ose kur plotësohen kushtet e bashkëngjitura kontratës.

(q) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të pasasë dhe, sipas rastit, reziqet specifike të detyrimit.

(r) Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të cilat sjellin përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të siguruar prapagun minimal ligjor për pensionet në Shqipëri nën një plan të përcaktuar pensioni. Kontributet e Shoqërisë për planin e përfitimit të pensionit regjistrohen në humbje ose fitim atëherë kur ndodhin.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(s) Standarte dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 janarit 2017; megjithatë, Shoqëria nuk ka zbatuar standardet e mëposhtme të reja ose të ndryshuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

SNRF 9 Instrumentet Financiare

SNRF 9, publikuar në korrik 2014, zëvendëson udhëzimet ekzistuese në SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përfshin udhëzime të rishikuara për klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke përfshirë një model të ri të humbjeve të pritshme të kreditit për e llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe kërkesat e reja të përgjithshme të kontabilitetit mbrojtës. Ajo gjithashtu përcjell udhëzimet për njohjen dhe çregjistrimin e instrumenteve financiare nga SNK 39.

SNRF 9 është efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, me lejimin e adoptimit të hershëm.

Shoqëria do të zbatojë SNRF 9 të nxjerrë në korrik 2014, fillimisht më 1 janar 2018 dhe do të miratojë ndryshimet e SNRF 9 në të njëjtën datë.

Bazuar në vlerësimin e ndërmarrë deri më sot, rregullimi total i parashikuar i adoptimit të SNRF 9 në bilancin fillestar në fitimet e pashpërndara të Shoqërisë në 1 janar 2018 është rreth 44,858 mijë lekë dhe lidhet me reduktimin e huave dhe paradhënie klientëve për pasoje të kërkesave të zhvlerësimit.

Vlerësimi i mësipërm është paraprak sepse nuk është finalizuar me të gjitha veprimet e tranzicionit. Ndikimi aktual i adoptimit të SNRF 9 më 1 janar 2018 mund të ndryshojë sepse:

- SNRF 9 do të kërkojë që shoqëria të rishikojë procesin e saj të kontabilitetit dhe kontrollet e brendshme dhe këto ndryshime nuk janë ende të plota;
- Shoqëria nuk ka finalizuar testimin dhe vlerësimin e kontrolleve mbi sistemet e reja të teknologjisë dhe ndryshimet në kuadrin e qeverisjes;
- Shoqëria është duke adaptuar dhe finalizuar modelet e saj për llogaritjet e HPK; dhe
- Politikat e reja të kontabilitetit, supozimet, gjykimet dhe teknikat e vlerësimit të përdorura janë subjekt ndryshimi deri në datën kur Shoqëria të përfundojë pasqyrat e saj të para financiare që përfshijnë datën e aplikimit fillestar.

(i) Klasifikimi dhe matja - Aktivet financiare

SNRF 9 përmban një metodë të re klasifikimi dhe matjeje për aktivet financiare që pasqyrojnë modelin e biznesit në të cilin menaxhohen asetet dhe karakteristikat e tyre të fluksit të mjeteve monetare. Standardi përfshin tre kategori kryesore të klasifikimit për aktivet financiare: matur me koston e amortizuar, VDATGJ dhe VDNFH. Ai eliminon kategoritë ekzistuese të SNK 39 të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të vlefshme për shitje.

Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDNFH;

-Mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale; dhe

-Afati i saj kontraktual sjell në datat e specifikuara flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI) në shumën kryesore të papaguar.

Një aktiv financiar matet në VDATGJ vetëm nëse plotëson të dyja kushtet më poshtë dhe nuk është përcaktuar si në VDNFH:

-Mbahen brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit arrihet duke mbledhur të dyja flukset monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare; dhe

Afati i saj kontraktual sjell në datat e specifikuara flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(s) Standarte dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

(i) Klasifikimi dhe matja - Aktivet financiare (vazhdim)

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për tregtim, Shoqëria mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme të paraqesë ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në ATGJ. Këto zgjedhje bëhen në bazë të çdo investimi. Të gjitha aktivet financiare që nuk klasifikohen si të matura me koston e amortizuar ose VDATGJ siç përshkruhen më lart, maten në VDNFH. Përveç kësaj, në njohjen fillestare, Shoqëria mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar që plotëson kërkesat e tjera për t'u matur me koston e amortizuar ose në VDATGJ si në VDNFH nëse kështu eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje kontabël që do të lindte ndryshe.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Në vlerësimin e objektivit të modelit të biznesit, Shoqëria konsideroi informacionin e mëposhtëm:

- Politikat dhe objektivat për portofolin dhe veprimtaritë e këtyre politikave në praktikë, duke përfshirë nëse strategjia e menaxhimit fokusohet në fitimin e të ardhurave nga interesi kontraktual;
- Si vlerësohet dhe raportohet performanca e portofolit tek drejtimi i Shoqërisë;
- Rreziqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi) dhe mënyrën se si menaxhohen ato rreziqe;

Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, Shoqëria ka konsideruar kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që ajo të mos plotësojë këtë kusht.

Shoqëria vlerëson se standardi nuk do të ndikojë në mënyrë thelbësore në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të mbajtura më 1 janar 2018 dhe në kapital sepse:

-Huatë dhe paradhëniet për klientët që klasifikohen si hua dhe të arkëtueshme dhe maten me koston e amortizuar sipas SNK 39 në përgjithësi gjithashtu do të maten me koston e amortizuar sipas SNRF 9;

-Huatë dhe paradhëniet për institucionet financiare që klasifikohen si hua dhe të arkëtueshme dhe maten me koston e amortizuar sipas SNK 39 do të maten në përgjithësi gjithashtu me koston e amortizuar sipas SNRF 9;

(ii) Zhvlerësimi - Aktivet financiare

SNRF 9 zëvendëson modelin e “humbjeve të ndodhura” në SNK 39 me një model të “humbjeve të pritshme të kreditit” në të ardhmen. Ky model do të kërkojë gjykime të konsiderueshme se si ndryshimet në faktorët ekonomikë ndikojnë në HPK, të cilat do të përcaktohen në bazë të probabilitetit të ponderuar.

Modeli i ri i zhvlerësimit do të zbatohet për aktivet financiare të cilat nuk maten me VDNFH. Sipas SNRF 9, nuk njihen humbje nga zhvlerësimi për investime në letrat me vlerë të kapitalit. Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 janë komplekse dhe kërkojnë gjykime, vlerësime dhe supozime nga drejtimi, veçanërisht në fushat e mëposhtme, të cilat diskutohen në detaje si më poshtë:
-Vlerësimi nëse rreziku i kreditit të një instrumenti është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga njohja fillestare; dhe

-Përfshirja e informacioneve mbi të ardhmen në matjen e HPK-ve.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(s) Standarte dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

(ii) Zhvlerësimi - Aktivet financiare (vazhdim)

SNRF 9 kërkon njohjen e një zhvlerësimi për humbje të barabartë me HPK 12-mujore ose me HPK përgjatë gjithë jetës së instrumentit. HPK-të përgjatë gjithë jetës së instrumentit janë HPK-të që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të dështimit përgjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar, ndërsa HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit.

Aktivët financiarë që janë të zhvlerësuar përcaktohen nga SNRF 9 në mënyrë të ngjashme me aktivët financiarë të zhvlerësuar sipas SNK 39.

Përkufizimi i mos-pagimit

Sipas SNRF 9, Shoqëria do të konsiderojë një aktiv financiar të humbur kur:

-Huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë të gjitha detyrimet e huasë ndaj Shoqërisë, pa u ndërmarrë nga Shoqëria veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka ndonjë të tillë); ose

-Huamarrësi është në vonesë më shumë se 90 ditë, për çdo detyrim material të huasë ndaj Shoqërine.

Gjatë vlerësimit nëse një huamarrës ka dështuar në pagim, Shoqëria do të marrë parasysh treguesit cilësorë, p.sh. thyrjet e termave; dhe treguesit sasiorë, p.sh. statusi i vonuar dhe mospagesa e një detyrimi tjetër të një emetuesi të njëjtë.

Inputet në matjen e ECLs

Inputet kryesore në matjen e HPK-ve kanë të ngjarë të jenë struktura e termave të variabla në vijim:

- Probabiliteti për dështim (PD)
- Humbja nga dështimi (HND); dhe
- Ekspozimi në rast dështimi (END)

Këto parametra do të rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara nga vetë Shoqëria. Ato do të rregullohen për të pasqyruar informacionin mbi të ardhmen.

Vlerësimet e PD-së do të llogariten duke u bazuar në modelet statistikore të vetë Shoqërisë duke marrë parasysh faktorët sasiorë dhe cilësorë.

HND është shkalla e humbjes së mundshme në rast dështimi. Shoqëria do të vlerësojë parametrat e HND bazuar në historinë e normave të rikuperimeve të pretendimeve përkundrejt palëve të dështuara. HND do të llogaritet në bazë të fluksit të parave të skontuar duke përdorur normën efektive të interesit si faktor zbritje.

END përfaqëson ekspozimin e pritur në rast dështimi. Shoqëria do të nxjerrë END nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës, përfshirë amortizimin dhe parapagimet. END e një aktivi financiar do të jetë vlera kontabël bruto e dështimit.

Ndikimi më i rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë nga zbatimi i SNRF 9 pritet të vijë si rezultat i kërkesave të reja të zhvlerësimit në lidhje me HPK-të 12-mujore dhe HPK e përjetshme për shkak të modelit që është i bazuar në informacionet e ardhshme.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(s) Standarte dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

(iii) Detyrimet financiare

Klasifikimi dhe matja

SNRF 9 kryesisht ruan kërkesat ekzistuese të SNK 39 për klasifikimin e detyrimeve financiare. Megjithatë, sipas SNK 39, të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të detyrimeve financiare të përcaktuara si në VDNFH njihen në fitim ose humbje, ndërsa sipas SNRF 9 këto ndryshime në vlerën e drejtë do të paraqiten në përgjithësi si më poshtë:

- Shuma e ndryshimit në vlerën e drejtë që lidhet me ndryshimet në rrezikun e kreditit së detyrimit do të paraqitet në ATGJ; dhe

- Shuma e mbetur e ndryshimit në vlerën e drejtë do të paraqitet në fitim ose humbje. Shoqëria nuk ka letra me vlerë të emetuara në VDNFH dhe nuk mban derivativë në VDNFH dhe për këtë arsye nuk ka mospërputhje kontabël që do të lindte ndryshe.

Ç'regjistrimi dhe modifikimi i kontratës

SNRF 9 përfshin kërkesat e SNK 39 për çregjistrimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare pa ndonjë ndryshim thelbësor. Megjithatë, përmban udhëzime specifike për kontabilitetin kur modifikimi i një instrumenti financiar që nuk matet në VDNFH nuk rezulton në çregjistrim. Sipas SNRF 9, Shoqëria do të rillogarisë vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar (ose koston e amortizuar të detyrimeve financiare) duke skontuar flukset monetare kontraktuale të modifikuara me normën origjinale të interesit efektiv dhe të njohë çdo rregullim që rezulton si ndryshim në fitim ose humbje. Sipas SNK 39, Shoqëria nuk njeh ndonjë fitim ose humbje në fitim ose humbje nga modifikimet e detyrimeve financiare. Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim material nga miratimi i këtyre kërkesave të reja.

(iv) Ndikimi në planifikimin e kapitalit

Shoqëria do të njohë ndikimin e adoptimit të standardit në fitimet e pashpërndara duke njohur ndikimin e plotë në ditën e adoptimit, duke filluar nga 1 janari 2018. Ndikimi në kapitalin rregullator të Shoqërisë është një reduktim në raportin e kapitalit ndaj totalit të aktiveve me 0.8%, nga 22.4% në 23.6%.

(v) Tranzicioni

Shoqëria do të përfitojë nga përjashtimi duke mos lejuar rishikimin e informacionit krahasues për periudhat paraprake të mëparshme në lidhje me ndryshimet në klasifikimet dhe matjet (duke përfshirë zhvlerësimin). Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që rezultojnë nga adoptimi i SNRF 9 në përgjithësi njihen në fitimet dhe rezervat e pashpërndara më 1 janar 2018.

SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët

SNRF 15 krijon një kuadër gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur të ardhurat njihen. Ai zëvendëson standardet ekzistuese për njohjen e të ardhurave, duke përfshirë SNK 18 Të Ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe KIRFN 13 Programet e Besnikërisë së Konsumatorëve.

SNRF 15 është efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018, me lejimin e adoptimit të hershëm.

Edhe pse nuk ka përfunduar plotësisht vlerësimin fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 në pasqyrat financiare të Shoqërisë, menaxhimi nuk pret që standardi i ri, kur të aplikohet fillimisht, do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Koha dhe matja e të ardhurave të Shoqërisë nuk pritet të ndryshojë sipas SNRF 15 për shkak të natyrës së veprimeve dhe llojeve të të ardhurave që fiton.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(s) Standarte dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara (vazhdim)

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese të qirasë, duke përfshirë SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimin nëse një Marrëveshje përmban një Qira, KIS-15 Qiratë Operative - Nxitjet dhe KIS-27 Vlerësimi i thelbit të transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të një qiraje.

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Adoptimi i hershëm është i lejuar për subjektet që zbatojnë SNRF 15 në ose para datës së zbatimit fillestar të SNRF 16.

SNRF 16 paraqet një model të vetëm kontabël të bilancit të qirasë për qiramarrësit. Një qiramarrës njihet të drejtën e përdorimit të aktivitetit që përfaqëson të drejtën e përdorimit të aktivitetit bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa të qirasë. Ekzistojnë përjashtime për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e sendeve me vlerë të vogël.

Kontabiliteti i qira-dhënësit mbetet i ngjashëm me standardin aktual - pra, qiradhënësit vazhdojnë të klasifikojnë qiratë si financiare ose operative.

Shoqëria ka përfunduar një vlerësim fillestar të ndikimit të mundshëm në pasqyrat financiare të tij, por ende nuk ka përfunduar vlerësimin e tij të hollësishëm. Ndikimi aktual i zbatimit të SNRF 16 në pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit fillestar do të varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, duke përfshirë normën e huamarrjes së Shoqërisë më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirasë të Shoqërisë në atë datë, vlerësimin më të fundit të Shoqërisë nëse do të ushtrojë opsionet e rinovimit të qirasë dhe shkallën në të cilën Shoqëria zgjedh të përdorë mjetet praktike dhe përjashtimet e njohjes.

Deri më tani, ndikimi më i rëndësishëm i identifikuar është se Shoqëria do të njohë aktive dhe detyrime e reja për qiratë operative të zyrave. Më 31 dhjetor 2017, pagesat minimale të ardhshme të qirasë në bazë të qirave operative arritën në 11,619 mijë lekë (shih Shënimin 30 (a)).

Përveç kësaj, natyra e shpenzimeve që lidhen me këto qira do të ndryshojë pasi SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e drejtpërdrejta të qirasë së qirasë me një zhvlerësim për të drejtën e përdorimit të aktiveve dhe shpenzimeve të interesit mbi detyrimet e qirasë.

Standarde të tjera

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë:

- Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 Cikli - Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28;
- Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione (Ndryshimet në SNRF 2);
- Transferimet e Pronës së Investimit (Ndryshimet në SNK 40);
- Shitja ose Kontributi i Aseteve midis një Investitori dhe Shoqatës së saj ose Sipërmarrjes së Përbashkët (Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28);
- KIRFN 22 Transaksionet në valutë të huaj dhe Konsiderata paraprake;
- KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhet;
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (Ndryshime në SNRF 9);
- Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28);
- Përmirësimet vjetore të SNRF 2015-2017 Cikli - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23);
- Ndryshimi i planit, kufizimi ose shlyerja (Ndryshimet në SNK 19)

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit.

(a) Struktura e administrimit të rrezikut

Këshilli Administrativ i Shoqërisë ka përgjegjësinë e përgjithshme për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut të Shoqërisë. Grupi i Drejtuesve Kryesorë është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikës të administrimit të rrezikut në këto çështje.

Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë janë ngritur për të identifikuar dhe analizuar risqet me të cilat përballlet Shoqëria, për të përcaktuar limitet dhe kontrollet, dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqëria, nëpërmjet standarteve dhe procedurave të saj të administrimit dhe trajnimit, ruan një ambjent kontrolli dobisjellës dhe të disiplinuar.

(b) Rreziku i kredisë

Gjatë veprimtarisë së saj, Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhënë klientëve, nga fondet e vendosura pranë institucioneve të tjera financiare dhe nga zërat jashtë pasqyrës së pozicionit financiar (p.sh. angazhimet për huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve).

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient apo pala tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe nga fondet pranë institucioneve të tjera financiare dhe zërat e tjerë të parregjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, Shoqëria konsideron dhe mbledh të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si p.sh rreziku i dështimit të një huamarrësi të veçantë, dhe rreziku i sektorit). Shoqëria bën paraprakisht vlerësimin e rrezikut të kreditit që përfshin pozicionin financiar të debitorit dhe aftësinë e tij paguese. Vlerësimi bëhet nga oficeri i kredisë dhe rishikohet nga njësia e rrezikut të kreditit.

Shoqëria administron rrezikun e kredisë në mënyrë të vazhdueshme duke monitoruar drejtpërdrejt limitet e kredisë, portofolin e kredisë dhe përqëndrimin e ekspozimit.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Reziku i kredisë (vazhdim)

(i) Administrimi i rrezikut të kredisë

Këshilli Administrativ, duke qënë përgjegjës për administrimin dhe monitorimin e rrezikut të kredisë, ka deleguar përgjegjësinë për vendimmarrje lidhur me rrezikun e kredisë tek Komiteti i Kredisë, Komiteti i Rrezikut të Kredisë dhe Departamenti i Rrezikut të Kredisë, përfshirë:

- *Formulimin e politikave të kredisë* në këshillim me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat mbi kolateralin, vlerësimin e kredisë, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, procedurat dokumentuese dhe ligjore, dhe pajtueshmërinë me kërkesat statutores.
- *Themelimin e strukturës autorizuese* për aprovimin dhe rinovimin e linjave të kredive nga autoritete të ndryshme brenda Shoqërisë (p.sh., Komiteti i Kredisë së Degës).
- *Rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë ndaj klientëve*. Departamenti i Rrezikut të Kredisë së Shoqërisë vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë, të cilat kalojnë limitet e përcaktuara, përpara aprovimit final dhe disbursimit. Rinovimet dhe rishikimet e kredive janë subjekt i të njëjtit proces.
- *Kufizimin e përqëndrimeve të ekspozimit* ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive (për huatë dhe paradhëniet), emetuesve, limiteve të klasifikimit të kredive, likuiditetit të tregut dhe vendit (për letrat me vlerë të investimit).
- *Zhvillimin dhe mbajtjen e kategorive të rrezikut të Shoqërisë* në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare dhe të fokusojë drejtuesit në rreziqet e pritshme. Kategorizimi i rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen provizione për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike të kreditit. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut adoptuar në përputhje me rregulloret e Bankës së Shqipërisë, përbëhet nga 5 shkallë, të cilat reflektojnë nivele të ndryshme të rrezikut të mospagimit dhe vlefshmërisë të kolateraleve, ose mundësive të tjera për të zvogeluar rrezikun e kredisë. Përgjegjësia për të caktuar shkallët e rrezikut është e Komitetit të Kredisë. Kategoritë e rrezikut janë subjekt i rishikimeve mujore nga Komiteti i Rrezikut të Kredisë.
- *Vëzhgimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit*, përfshirë ato për industritë e zgjedhura dhe llojeve të produkteve. Raporte mujore mbi cilësinë e kredisë dhe trendeve i dërgohen Komitetit të Kredisë dhe në bazë të tyre merren masa korrigjuese.
- *Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësive të specializuara* ndaj njësive të biznesit për të zhvilluar praktikat më të mira të administrimit të rrezikut të kredisë në të gjithë Shoqërinë.

Çdo njësi biznesi është e detyruar të zbatojë politikën dhe procedurat e kredisë në përputhje me autoritetet aprovese të deleguara. Përqëndrimi i rrezikut të kredisë i cili vjen nga instrumentet financiare ekziston për palët e tjera kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të bënin që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike ose kushte të tjera. Shumica e përqëndrimit të rrezikut të kredisë vjen nga lloji i klientit në lidhje me huatë dhënë klientëve nga Shoqëria.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

Tabela e mëposhtme tregon ekspozimin maksimal aktual ndaj rrezikut të kredisë për komponentët e aplikueshëm të pozicionit financiar:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to (përfshirë)		
mjetet monetare në arkë)	271,594	294,313
Hua ndaj institucioneve financiare	40,664	70,014
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve	3,990,359	3,839,702
	4,302,617	4,204,029

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe huatë ndaj institucioneve financiare nuk janë me ditevonesë dhe as të zhvlerësuar.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

Hua dhe paradhënie klientëve	2017	2016
<i>Të provizionuara individualisht</i>		
Standarde	-	-
Të ristrukturuara	1,725	2,673
31- 90 ditë vonesë	-	-
91 – 180 ditë vonesë	43,318	37,725
181 – 365 ditë vonesë	182,737	188,113
Mbi 365 ditë vonesë	-	-
Shuma bruto	227,780	228,511
Fondi për provision	(227,780)	(228,511)
<i>Të provizionuara në mënyrë kolektive</i>		
Standarde	3,842,023	3,721,928
Të ristrukturuara	54,305	45,922
31- 90 ditë vonesë	86,045	70,545
91 – 180 ditë vonesë	40,887	21,887
181 – 365 ditë vonesë	420	4,043
Mbi 365 ditë vonesë	-	-
Shuma bruto	4,023,680	3,864,325
Fondi për provision	(101,199)	(88,576)
	3,922,481	3,775,749
Interet i përlllogaritur	67,878	63,953
Vlera kontabël neto	3,990,359	3,839,702

Huatë dhe paradhëniet për klientët janë klasa e vetme e aktiveve financiare që rezultojnë në kategori jo-performuese, të cilat nuk janë domosdoshmërisht subjekt i vlerësimit individual të zhvlerësimit.

Hua të zhvlerësuara

Hua të zhvlerësuar janë ato hua për të cilat Shoqëria ka përcaktuar se është e mundur që ajo mos jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe të principalit në bazë të kushteve të kontratës.

Hua me kushte të ndryshuara

Hua me kushte të ndryshuara janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe sepse Shoqëria mendon që ky përkeqësim është i përkohshëm dhe ajo ka bërë lëshime të cilat nuk do t'i bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar klasifikimi i saj përcaktohet sipas rregulloreve të Bankës së Shqipërisë.

Fondi për zhvlerësim

Shoqëria vendos një fond për humbjet nga provizioni që përfaqëson vlerësimin e saj për humbjet e ndodhura në portofol. Përbërësit kryesorë të këtij fondi janë komponenti për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme individualisht dhe një fond provizioni kolektiv në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për provision.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Politika e nxjerrjes jashtë pasqyrës së pozicionit financiar

Shoqëria nxjerr jashtë pasqyrës së pozicionit financiar (dhe çdo fond për humbje nga zhvlerësimi) kur ka ezauruar të gjitha mjetet ligjore për arketime pas 365 ditëve:

- të dorëzimit të kërkesës për ekzekutimin e kolateralit në zyrën e përmbarrimit kur kredia është e mbuluar me kolateral me pasurinë e paluajtshme ose të luajtshme; ose
- të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit të gjykatës në rast se kredia nuk është e mbuluar me kolateral me pasuri të paluajtshme ose të luajtshme.

Shoqëria mban kolateral kundrejt një grupi huash dhe paradhëniesh dhënë klientëve në formën e interesave hipotekore mbi një pronë, ose garanci të tjera të rregjistruara mbi këtë aktiv, dhe garancive. Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huasë, të cilat rishikohen kur huaja vlerësohet si e provizionuar individualisht.

Përqëndrimi i rrezikut sipas sektorit

Shoqëria monitoron përqëndrimet e riskut të kredisë nga sektori për kreditë saj dhe paradhëniet për klientët. Një analizë e rrezikut të përqëndrimit të sektorit në datën e raportimit paraqitet mëposhtë:

Sektori i industrisë	31 dhjetor 2017	%	31 dhjetor 2016	%
Shërbime	1,819,146	42.13	1,945,682	46.99
Tregti	836,440	19.37	726,837	17.55
Agrikulturë	1,079,599	25.00	959,307	23.17
Përmirësime për shtëpi	197,693	4.58	136,052	3.29
Prodhim	384,971	8.92	372,643	9.00
Totali	4,317,849	100.00	4,140,521	100.00
Parapagime	(66,389)		(47,685)	
Totali	4,251,460		4,092,836	

Rreziku i shlyerjes

Aktivitetet e Shoqërisë mund të shkaktojnë rrezik në momentin e shlyerjes së transaksioneve dhe veprimeve tregtare. Rreziku i shlyerjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një entiteti në përmbushjen e detyrimeve për të paguar në mjete monetare, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakord në kontratë. Departamenti i Rrezikut të Kredisë përgatit një analizë rreziku të kundërpartive dhe rekomandon vendosjen e limiteve të kundërpartive për Komitetin e Administrimit të Rrezikut. Komiteti i administrimit të rrezikut aprovon limitet e rrezikut të kundërpartive që përfshin rrezikun direkt dhe rrezikun e shlyerjes.

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të hasë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare të cilat shlyhen duke dhënë para ose një aktiv tjetër financiar.

(i) Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i Shoqërisë në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet në kohën e kërkuar si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pa-favorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar të dëmtojë emrin e saj. Njësia e Thesarit, merr informacion nga njësitet e tjera të biznesit lidhur me profilin e likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve të tyre financiare dhe detaje të flukseve të tjera monetare të projektuara të cilat vijnë nga biznesi i ardhshëm i projektuar.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

(i) Administrimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Njësia e Thesarit mban një portofol aktivesh afatshkurtra likuide, të përbërë kryesisht nga instrumentat e investimit afatshkurtra, hua dhe paradhënie dhënë Shoqërive dhe lehtësi të tjera ndërmjet Shoqërive, për të siguruar mbajtjen e likuiditetit të mjaftueshëm të Shoqërisë në tërësi.

Kërkesat e likuiditetit plotësohen nëpërmjet overdrifteve dhe kredive afatshkurtra të marra për të mbuluar ndonjë luhatje afatshkurtër dhe burimeve më afatgjata të fondeve për tju përgjigjur kërkesave strukturore të likuiditetit. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit i nënshtrohen rishikimit të Komitetit të Aktiveve dhe Detyrimeve ("ALCO"). ALCO gjithashtu administron boshllëqet e përgjithshme të Shoqërisë dhe vendos limite të përshtatshme. Raportet ditore të likuiditetit monitorohen nga Njësia e Thesarit. Shoqëria monitoron likuiditetin në baza ditore në mënyrë që të administrojë detyrimet në kohën e kërkuar.

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Politikat e brendshme të Shoqërisë parashikojnë që kjo e fundit të mbajë një limit kumulativ të likuiditetit jo më pak se 20% të kapitalit. Shoqëria mund të investojë maksimumi 100% të fondeve të lira në ndonjë depozitë ose investim afatshkurtër në bankat lokale që kanë kundërparti me limite të aprovuara. Më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, aktivet dhe detyrimet financiare kanë maturitet të mbetur si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Totali
31 dhjetor 2017					
Aktivët financiarë					
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	272,646	-	-	-	272,646
Hua institucioneve financiare	21,381	10,218	9,065	-	40,664
Hua dhe paradhënie klientëve	200,933	276,000	1,261,010	2,252,416	3,990,359
Totali i aktiveve financiare	494,960	286,218	1,270,075	2,252,416	4,303,669
Detyrimet financiare					
Hua	221,097	114,552	1,106,972	1,771,112	3,213,733
Obligacione	-	-	-	81,867	81,867
Grante	232	463	2,071	230	2,996
Totali i detyrimeve financiare	221,329	115,015	1,109,043	1,853,209	3,298,596
Pozicioni neto	273,631	171,203	161,032	399,207	1,005,073
	Deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Totali
31 dhjetor 2016					
Aktivët					
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	296,217	-	-	-	296,217
Hua institucioneve financiare	7,891	1,322	59,752	1,049	70,014
Hua dhe paradhënie klientëve	210,270	267,154	1,248,743	2,113,535	3,839,702
Totali i aktiveve financiare	514,378	268,476	1,308,495	2,114,584	4,205,933
Detyrimet					
Hua	36,094	297,765	1,094,395	1,862,911	3,291,165
Grante	392	785	3,972	2,997	8,146
Totali i detyrimeve financiare	36,486	298,550	1,098,367	1,865,908	3,299,311
Pozicioni neto	477,892	(30,074)	210,128	248,676	906,622
Pozicioni kumulativ neto	477,892	447,818	657,946	906,622	-

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në balancën e kredisë të huamarrësit/emetuesit), do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë apo vlerën e instrumentave financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të administrojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

(i) Ekspozimi ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit

Rreziku i kurseve të huaja të këmbimit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të ndryshojë me ndryshimin e kurseve të këmbimit. Transaksionet e Shoqërisë gjenerojnë fitime dhe humbje nga kurset e këmbimit të cilat njihen në humbje ose fitim. Keto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet monetare të Shoqërisë të cilat nuk janë të shprehura në monedhën matëse të saj. Shoqëria e menaxhon këtë rrezik duke kontrolluar madhësinë e diferencës ndërmjet vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të shprehura në monedhën të huaj.

Kurset e aplikueshme të këmbimit (Lek ndaj njësisë së monedhës së huaj) për monedhat parësore në 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
1 EUR	132.95	135.23
1 USD	111.10	128.17

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit monitorohet në mënyrë të vazhdueshme duke siguruar përputhshmëri me limitet rregullatore dhe rregulloret e brendshme të Shoqërisë. Këto limite i referohen një maksimumi prej 20% të pozicionit të hapur në secilën monedhë dhe 30% të pozicionit të përgjithshëm të hapur të monedhës.

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 sipas monedhave të huaja në të cilat ato shprehen, ishte si më poshtë (shumat të përkthyer në Lek):

31 dhjetor 2017	LEK	EUR	USD	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	111,112	161,493	41	272,646
Hua institucioneve financiare	1,079	1,873,829	-	1,874,908
Hua dhe paradhënie klientëve	3,907,562	82,797	-	3,990,359
Totali i aktiveve monetare	4,019,753	2,118,119	41	6,137,913
Detyrimet financiare				
Hua	2,949,921	2,098,056	-	5,047,977
Obligacione	81,867	-	-	81,867
Grante	2,996	-	-	2,996
Totali i detyrimeve financiare	3,034,784	2,098,056	-	5,132,840
Pozicioni neto	984,969	20,063	41	1,005,073

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

(i) Ekspozimi ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit (vazhdim)

31 dhjetor 2016	LEK	EUR	Totali
Aktivet monetare			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	296,217	-	296,217
Hua institucioneve financiare	1,049	1,691,163	1,692,212
Hua dhe paradhanie klientëve	3,771,666	68,036	3,839,702
Totali i aktiveve financiare	4,068,932	1,759,199	5,828,131
Detyrimet monetare			
Hua	3,083,700	1,829,663	4,913,363
Grante	5,777	2,369	8,146
Totali i detyrimeve financiare	3,089,477	1,832,032	4,921,509
Pozicioni neto	979,455	(72,833)	906,622

Informacioni i dhënë dallon nga pasqyra e pozicionit financiar ku huatë ndaj institucioneve financiare në Euro, në shumën 1,834,244 mijë Lek (2016:1,622,198 mijë Lek) janë netuar me balancat e overdraftit të marrë nga Shoqëria nga bankat duke përdorur këto kredi si kolaterale monetare në përputhje me kontratat e kredive respective dhe në bazë të qëllimit të shlyerjes duke netuar shumat përkatëse.

Analiza e ndryshimeve të efekteve të ndryshimeve në kursin e këmbimit në fitimin neto më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj monedhës së huaj në datën e raportimit të mbajtur konstante gjatë gjithë periudhës:

	100 bp Rritje paralele	100 bp Rënie paralele	50 bp Rritje paralele	50 bp Rënie paralele
2017				
At 31 dhjetor 2017	2,006	(2,006)	1,003	(1,003)
	100 bp Rritje paralele	100 bp Rënie paralele	50 bp Rritje paralele	50 bp Rënie paralele
2016				
At 31 dhjetor 2016	7,183	(7,183)	3,591	(3,591)

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të ndryshojë me ndryshimin e normave të interesit në treg. Shoqëria e administron rrezikun e normës së interesit duke monitoruar kushtet e tregut e duke aplikuar çmime të nevojshme duke u bazuar në analizën e kostos për çdo produkt. Huatë e NOA-s janë me interes fiks dhe shumica e tyre janë me terma më pak se 5 vjet.

Informacioni mbi normën efektive

Normat mesatare efektive të kategorive kryesore të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	EURO	LEK	EURO	LEK
Aktivet				
Hua të arkëtueshme nga institucionet financiare	0.47%	3.00%	0.70%	3.00%
Hua të arkëtueshme nga klientët	14.72%	21.79%	14.04%	22.77%
Detyrimet				
Hua	5.53%	4.16%	5.82%	4.93%
Obligacione	-	7%	-	-

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit (vazhdim)

Analiza e ricimit të normës së interesit

Tabela e mëposhtme paraqet datat e ricimit të normave të interesit për aktivet dhe detyrimet monetare të Shoqërisë. Aktivet dhe detyrimet me normë të ndryshueshme janë raportuar sipas datës së ardhshme të ndryshimit të normës së interesit. Aktivet me normë fikse interesi janë raportuar sipas datës së skeduar të ripagimit të principalit.

31 Dhjetor 2017							
Aktivitet:	IEF	Totali	6 muaj ose më pak	6 deri 12 muaj	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalente me to (shënimi 16)	0.00%	272,646	272,646	-	-	-	-
Hua institucioneve financiare (shënimi 17)	0.48%	40,664	40,574	90	-	-	-
Hua dhe paradhënie ndaj klientët (shënimi 18)	22.6%	3,922,481	811,262	858,804	1,203,502	1,031,320	17,593
Totali i aktiveve		4,235,791	1,124,482	858,894	1,203,502	1,031,320	17,593
Detyrimet:							
Hua me normë interesi fikse (shënimi 23)	5.80%	2,508,190	207,030	504,206	1,036,036	760,918	-
Obligacione me normë interesi fikse (nota 24)	7%	80,000	-	-	-	80,000	-
Hua me normë interesi variable (shënimi 23)	7.22%	669,451	424,853	244,598	-	-	-
Totali i detyrimeve		3,247,641	631,883	748,804	1,036,036	840,918	-
Pozicioni neto		1,058,149	492,599	110,089	167,466	270,402	17,593
31 Dhjetor 2016							
Asetet:	IEF	Totali	6 muaj ose me pak	6 deri 12 muaj	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre (shënimi 16)	0.00%	296,217	296,217	-	-	-	-
Hua të arkëtueshme nga institucionet inanciare (shënimi 17)	0.70%	70,014	23,838	45,127	1,049	-	-
Hua të arkëtueshme nga klientët (shënimi 18)	22.6%	3,775,749	813,996	848,218	1,188,480	894,849	30,206
Totali i aktiveve		4,141,980	1,134,051	893,345	1,189,529	894,849	30,206
Hua :							
Hua me normë interesi fikse (shënimi 23)	4.68%	2,660,922	191,153	633,585	833,042	1,003,142	-
Hua me normë interesi variable (shënimi 23)	7.89%	599,418	353,010	246,408	-	-	-
Totali i detyrimeve		3,260,340	544,163	879,993	833,042	1,003,142	-
Pozicioni neto		881,640	589,888	13,352	356,487	(108,293)	30,206

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

(ii) Analiza e rëzimit të normës së interesit (vazhdim)

Administrimi i normave të interesit brenda limitit të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë duke përdorur skenare të ndryshme standarde dhe jo standarde të normave të interesit. Skenarët standarde të cilat konsiderohen një herë në muaj përfshijnë një rënie ose rritje paralele me bazë pikësh 100 (bp) në të gjitha kurbat e kthimit në bote dhe një rritje ose rënie prej bp 50 në pjesën më të madhe se 12-muaj të të gjitha kurbave të kthimit. Një analizë e ndjeshmërisë së Shoqërisë për një rritje ose ulje të normave të interesit të tregut për fondet e marra hua është si më poshtë:

	100 pb Rritje Paralele	100 pb Rënie paralele	50 pb Rritje paralele	50 pb Rënie Paralele
2017				
Më 31 dhjetor 2017	10,581	(10,581)	5,291	(5,291)
	100 pb Rritje paralele	100 pb Rënie paralele	50 pb Rritje paralele	50 pb Rënie paralele
2016				
Më 31 dhjetor 2016	8,816	(8,816)	4,408	(4,408)

Rreziku i përgjithshëm i normës së interesit administrohet nëpërmjet përdorimit të paradhënieve dhënë bankave, depozitave nga bankat dhe instrumentave derivative.

(e) Rreziqet operacionale

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkakesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Shoqërisë, dhe nga faktorë të jashtëm përveç risqeve të kredisë, tregut dhe likuiditetit si p.sh ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregulluese si edhe nga standardet pergjithësisht të pranuar të sjelljes korporative. Risqet operacionale lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Shoqërisë dhe janë risqe që hasen nga të gjitha shoqëritë ne biznes.

Objekti i Shoqërisë është të administrojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmagien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë me efektivitetin e përgjithshëm të kostove, si edhe të shmangë procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Përgjegjësia parësore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve që të adresohet rreziku operacional i caktohet drejtuesve të lartë në çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Shoqërisë për administrimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesa për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtimi me kërkesat ligjore dhe rregullative
- dokumentimi i kontrolleve dhe i procedurave
- kërkesa për vlerësimin periodik të risqeve operacionale të identifikuar dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar risqet e identifikuar
- kërkesa për raportimin e humbjeve operative dhe veprimit rregullues të propozuar
- zhvillimi i planeve emergjencës

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(e) Rreziqet operacionale (vazhdim)

- trajnimi dhe zhvillimi profesional
- standardet e etikës dhe biznesit
- lehtësimin e rrezikut, duke përfshirë sigurimin në rastet kur është efektiv

Pajtimi me standardet e Shoqërisë mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Audit i Brendshëm. Rezultatet e rishikimit të auditimit të brendshëm diskutohen me drejtimin e njësive të biznesit, duke përgatitur përmbledhje të cilat i paraqiten Komitetit të Auditimit dhe drejtimit të lartë të Shoqërisë.

(f) Administrimi i kapitalit

Kapitali rregullator

Shoqëria është subjekt i disa kërkesave rregullore me të cilat ajo duhet të pajtohet. NOA-s i kërkohet nga Banka e Shqipërisë që t'i përmbahet kërkesave të mëposhtme:

- Raporti i kapitalit ndaj totalit të aktivitetit nuk duhet të jetë më i vogël se 10%.
- Raporti i kapitalit ndaj mjeteve fikse të trupëzuara dhe jo-të trupëzuara neto nuk duhet të jetë më i vogël se 100%.
- Raporti i kapitalit ndaj totalit të huave me probleme nuk duhet të jete më i vogël se 100%.
- Raporti i kapitalit i paguar në natyrë ndaj kapitalit nuk duhet të kalojë 50%.
- Ekspozimi ndaj një personi apo një grupi palësh të lidhura nuk duhet të jetë më shumë se 15% e kapitalit.

Më 31 dhjetor 2017 kërkesat e mësipërme janë plotësuar plotësisht duke përfshirë raportin e kapitalit ndaj totalit të aktiveve që është 24.43 %. Politika e Shoqërisë është për ruajtjen e një baze kapitali brenda limiteve, duke kapitalizuar të gjitha të ardhurat nga aktiviteti për të mbështetur zhvillimin në të ardhmen. Shoqëria njeh nevojën për të patur një balancë ndërmjet të ardhurave të larta që janë të mundshme nëpërmjet kredimarrjes së lartë dhe avantazheve dhe sigurisë që lejon një pozicion të shëndoshë të kapitalit. Nuk ka patur ndryshime të rëndësishme në manaxhimin e kapitalit të Shoqërisë gjatë periudhës.

6. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Shoqëria bën vlerësime dhe gjykime të cilat ndikojnë vlerat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar, dhe që rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë mbi ngjarjet e ardhshme të cilat mendohen të jenë të arsyeshme sipas rrethanave.

(i) Tatim fitimi

Drejtimi beson se llogaritja e tatimit mbi fitimin është e përshtatshme pavarësisht pasigurive që ekzistojnë në mjedisin tatimor shqiptar dhe në legjislacionin në fuqi dhe se vizitat e ardhshme fiskale nuk do të sjellin efekte të rëndësishme në pasqyrat e pozicionit financiar, rezultatin nga aktiviteti apo në flukset monetare. Gjithsesi, duke u bazuar në natyrën e ligjit mbi tatimin e të ardhurave dhe udhëzimeve përkatëse nuk është e mundur që të jemi të sigurt se pozicioni fiskal do mbetet i pandryshuar nga autoritetet tatimore.

(ii) Fonde për humbjet nga huatë dhe paradhëniet

Shoqëria rishikon në bazë mujore portofolin e kredisë për të përcaktuar humbjet nga zhvlerësimi. Për të përcaktuar nëse një humbje nga krediti duhet të rregjistrohet në humbje ose fitim, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme e cila tregon se ka rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhme hyrëse të parasë nga portofoli i kredive. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dukshme si një ndryshim i pafavorshëm në gjendjen e pagesave të huamarresit ndaj Shoqërisë ose ngjarje ekonomike kombëtare ose lokale të cilat lidhen me mospagimin e kredive. Drejtimi përdor llogaritje në bazë të përvojës së humbjeve të mëparshme për aktivet me karakteristika të riskut të kreditit dhe evidencë objektive për fonde të njejta me ato në portofol gjatë programimit të fluksevetvardhshme monetare. Metodologjia dhe supozimet e bëra për llogaritjen e shumës dhe kohës të flukseve të ardhshme monetare rishikohen rregullisht për të ulur ndonjë diferencë midis humbjes së llogaritur dhe eksperiencës me humbjet aktuale.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(iii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmime tregu të dukshme, kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit të përmendura në politikat kontabël 4(g),(vi). Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë transparencë të ulët të cmimit, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të shumë-anëshme gjykimi që varen nga likuiditeti, përqendrimi, pasiguria e faktorëve të tregut, supozimet mbi çmimin dhe risqe të tjera që ndikojnë instrumentin specifik. Shikoni gjithashtu “Vlerësimi i instrumenteve financiare” më poshtë.

(iv) Gjykime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Shoqërisë

Gjykime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Shoqërisë përfshijnë:

Vlerësimi i instrumentave financiare

Politika kontabël e Shoqërisë për matjen e vlerës së drejtë është trajtuar në shënimin 4(g)(vi)

Shoqëria mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmime të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në të dhëna të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur; çmime të kuotuar në tregje aktive për instrumenta të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumenta të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose jo-direkte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin të dhëna të rëndësishme të pa-vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë ato instrumente ku teknika e vlerësimit përfshin të dhëna që nuk janë të vëzhgueshme dhe të dhënat e pa-vëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm ku rregullimet apo gjykimet e rëndësishme të pa-vëzhgueshme kërkojnë për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Vlera e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime tregu të kuotuar ose kuotimeve të çmimit nga tregtarët. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiare Shoqëria përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumenta të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijnë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, i cili do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrës në treg që veprojnë me kushtet e tregut. Shoqëria përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumentave financiare më të thjeshtë dhe më të zakonshëm, si norma e interesit dhe SWAP-e të kurseve të këmbimit që përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim apo vlerësim nga drejtuesit. Çmimet e vëzhgueshme dhe të dhënat e modeleve janë zakonisht të gjendshme në tregun e borxhit të listuar dhe letrave të kapitalit, derivativeve të kurseve të tregtuara dhe të thjeshta mbi derivativet e kundërt si për shembull SWAP-et e normës së interesit. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe e inputeve në model redukton nevojën për gjykimin dhe vlerësimin e drejtuesve dhe redukton gjithashtu pasiguritë që shoqërojnë përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe të dhënave varion në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur ndaj ndryshimeve bazuar në ngjarje specifike dhe kushte të përgjithshme në tregjet financiare.

Për instrumenta financiare më komplekse, Shoqëria përdor modele vlerësimi të veçanta, të cilat janë zakonisht të zhvilluara nga modele të njohura vlerësimi. Disa ose të gjithë të dhënat e rëndësishme në këto modele mund të mos jenë të vëzhgueshme në treg, dhe janë rrjedhojë e çmimeve të tregut ose kurseve ose janë vlerësuar bazuar në gjykime. Modelet e vlerësimit që përmbajnë të dhëna të rëndësishme të pa-vëzhgueshme kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi dhe vlerësimi nga drejtuesit në përcaktimin e vlerës së drejtë. Gjykimi dhe vlerësimi i drejtuesve nevojitet zakonisht për zgjedhjen e modelit të vlerësimit do të përdoret, për përcaktimin e flukseve monetare të pritshme për instrumentin financiar që vlerësohet, përcaktimin e probabilitetit për mospagesën apo parapagimet nga pala tjetër dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme të skontimit.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

7. Aktive dhe detyrime financiare

Klasifikimi sipas kontabilitetit dhe vlera e drejtë

	Hua dhe paradhënie	Detyrime të tjera financiare	Totali i vlerës kontabël	Totali i vlerës së drejtë
31 dhjetor 2017				
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	272,646	-	272,646	272,646
Hua institucioneve financiare	40,664	-	40,664	40,664
Hua dhe paradhënie klientëve	3,990,359	-	3,990,359	3,990,359
Totali i aktiveve financiare	4,303,669	-	4,303,669	4,303,669
Detyrime financiare				
Hua	-	3,213,733	3,213,733	3,213,733
Obligacione	-	81,867	81,867	81,867
Totali i detyrimeve financiare	-	3,295,600	3,295,600	3,295,600
31 dhjetor 2016				
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	296,217	-	296,217	296,217
Hua institucioneve financiare	70,014	-	70,014	70,014
Hua dhe paradhënie klientëve	3,839,702	-	3,839,702	3,839,702
Totali i aktiveve financiare	4,205,933	-	4,205,933	4,205,933
Detyrime financiare				
Hua	-	3,291,165	3,291,165	3,291,165
Totali i detyrimeve financiare	-	3,291,165	3,291,165	3,291,165

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to dhe kredive ndaj institucioneve financiare për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër është shuma e arkëtueshme në datën e raportimit. Pjesa më e madhe e portofolit të huave dhe paradhënieve për klientët bazohet në normat fikse të interesit.

Drejtimi e konsideron si jo proktike të kryejë një llogaritjen e vlerës së drejtë të huave dhe paradhënieve për klientët pasi nuk ka transaksione të tregut të vëzhgueshme për kredi homogjene dhe beson se vlerat e drejta përafrojnë vlerën kontabël. Humbjet e pritshme në të ardhmen nuk merren në konsideratë.

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, të gjithë instrumentet financiarë të matur me vlerën e drejtë bazohen në hierarkinë e Nivelit 3.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. Të ardhurat nga interesat

Të ardhurat nga interesat për vitin 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Hua dhe paradhënie klientëve	872,072	888,040
Hua institucioneve financiare	11,574	12,457
Totali	883,646	900,497

9. Shpenzime për interesa

Shpenzimet për interesa për vitin 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Interes nga huatë	277,235	292,498
Totali	277,235	292,498

10. Tarifa dhe komisione, neto

Tarifat dhe komisionet neto përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Të ardhura nga komisione e aplikimit	68,217	50,053
Të ardhurat si agjent sigurimi	50,030	58,128
Komisione bankare	(3,332)	(1,406)
Totali	114,915	106,775

11. Rimarrjet nga kreditë dhe paradhëniet e fshira

	2017	2016
Rimarrje nga huatë dhe paradhëniet e fshira	172,339	144,888
Totali	172,339	144,888

12. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera për vitet 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Të ardhura nga granti (shënimi 25)	5,288	4,974
Të tjera	11,458	2,322
Totali	16,746	7,296

Të ardhurat nga grantet për vitet 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Të ardhura nga granti për pajisje / operacione	4,669	4,713
Të tjera	619	261
Totali	5,288	4,974

Te ardhura te tjera per vitin 2017 perfshijne rrimarjen nga çështja gjyqësore e tatim fitimit për shumën Lek 9,381.

13. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitet 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Pagat bruto	253,526	251,606
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	38,533	38,740
Shpërblime	35,741	42,258
Totali	327,800	332,604

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

14. Shpenzime të tjera

Shpenzime të tjera për vitet 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Konsulencë, tarifa ligjore dhe shërbime të tjera	57,124	52,548
Qira	41,569	41,545
Shpenzime për burime njerëzore dhe trajnime	28,784	8,972
Shpenzime transporti	16,975	15,947
Energji, uje etj.	14,205	14,909
Komisione menaxhimi	10,426	9,966
Reklama dhe promovime	10,402	10,546
Shpenzime komunikimi	9,351	10,392
Shpenzime sigurimi	4,885	4,297
Pajisje zyre	4,164	5,165
Të tjera	14,900	17,690
Totali	212,785	191,977

15. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në normën 15% të fitimit të tatueshëm. Më poshtë janë paraqitur tatimi aktual dhe i shtyrë të njohur në humbje ose fitim. Më poshtë është një rakordim i normës efektive të tatimit:

	2017	2016
Fitimi përpara tatimit	176,556	163,750
Shpenzim tatim fitimi aktual @ 15%	26,845	24,326
Shpenzimet e pazbritshme @ 15%	2,215	2,422
Shpenzim tatim fitimi neto	29,060	26,748

Tatim fitimi i parapaguar për vitin 2017 është Lek 30,618 mijë (2016: 13,891 mijë).

16. Aktivët monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare në arkë	1,052	1,904
Llogaritë rrjedhëse	271,594	294,313
Totali	272,646	296,217

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

17. Huatë Institucioneve Financiare

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Banka Kombetare Tregtare	-	35,214
Tirana Bank	(2,804)	(630)
Societe Generale Albania	10,560	(300)
International Commercial Bank	2,268	(632)
First Investment Bank	15,235	14,752
Veneto Bank	9,774	15,265
Totali i huave ndaj Institucioneve Financiare në Euro	35,033	63,669
Interes i përlogaritur	4,552	5,296
	39,585	68,965
Banka Kombetare Tregtare	1,000	1,000
Totali i huave ndaj Institucioneve Financiare në Lekë	1,000	1,000
Interes i përlogaritur	79	49
	1,079	1,049
Total huave ndaj institucioneve financiare	40,664	70,014

Sic është paraqitur në shënimin 5, Huatë ndaj Institucioneve Financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë paraqitur neto nga balancat e overdrafteve me vlerë respektivisht prej 1,834,244 Lek (2016: 1,803,468 Lek) . Maturiteti mesatar dhe norma mesatare e interesit per huatë në Euro dhe Lekë është respektivisht 12 muaj me normën 0.47% dhe 36 muaj me normën 3%.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

18. Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet e klientëve përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua klientëve, bruto	4,317,849	4,140,521
Interes i përllogaritur	67,878	63,953
Shuma të parapaguara	(66,389)	(47,685)
Fond provizioni	(328,979)	(317,087)
Në fund të periudhës	3,990,359	3,839,702

Lëvizja në fondin e provizionit për huatë e klientëve paraqitet si më poshtë:

	2017	2016
Më 1 janar	(317,087)	(326,557)
Fondi i provizionit për vitin	(164,777)	(148,763)
Efekti i kurseve të këmbimit	19	193
Të fshira	152,866	158,040
Në fund të periudhës	(328,979)	(317,087)

19. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë të përbëra si më poshtë:

	Pajisjet e elektronike	Automjete	Pajisje dhe mobilje	Përmiresime të ambienteve me qira	Totali
Kosto					
Më 1 janar 2016	124,243	37,196	33,477	19,078	213,994
Shtesa	11,298	-	178	30	11,506
Pakësime	-	-	(142)	-	(142)
Më 31 dhjetor 2016	135,541	37,196	33,513	19,108	225,358
Shtesa	4,080	-	2,654	1,219	7,953
Pakësime	(749)	-	(293)	-	(1,042)
Më 31 dhjetor 2017	138,872	37,196	35,874	20,327	232,269
Zhvlerësimi i akumuluar					
Më 1 janar 2016	(107,160)	(21,943)	(28,434)	(16,703)	(174,240)
Zhvlerësimi i vitit	(7,166)	(5,202)	(2,044)	(942)	(15,354)
Pakësime	-	-	138	-	138
Më 31 dhjetor 2016	(114,326)	(27,145)	(30,340)	(17,645)	(189,456)
Zhvlerësimi i vitit	(8,762)	(5,190)	(1,238)	(836)	(16,026)
Pakësime	-	-	292	-	292
Më 31 dhjetor 2017	(123,088)	(32,335)	(31,286)	(18,481)	(205,190)
Vlera Kontabël Neto					
Më 1 janar 2016	17,083	15,253	5,043	2,375	39,754
Më 31 dhjetor 2016	21,215	10,051	3,173	1,463	35,902
Më 31 dhjetor 2017	15,784	4,861	4,588	1,846	27,079

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

20. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivitet e qëndrueshme të patrupëzuara me 31 dhjetor 2017 dhe 2016, janë të përbëra si më poshtë:

	Programe kompjuterike dhe licenca	Aktive në proces	Total
Kosto			
Më 1 janar 2016	151,527	8,717	160,244
Shtesa	27,187		27,187
Pakësime	-	(8,717)	(8,717)
Më 31 dhjetor 2016	178,714	-	178,714
Shtesa	318	-	318
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	179,032	-	179,032
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 janar 2016	(133,196)		(133,196)
Amortizimi i vitit	(13,930)		(13,930)
Nxjerrje jashtë përdorimi	-		-
Më 31 dhjetor 2016	(147,126)	-	(147,126)
Amortizimi i vitit	(11,363)	-	(11,363)
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	(158,489)	-	(158,489)
Vlera kontabël neto			
Më 1 janar 2016	18,331	8,717	27,048
Më 31 dhjetor 2016	31,588	-	31,588
Më 31 dhjetor 2017	20,543	-	20,543

21. Aktive të shtyra tatimore

Aktivitet dhe detyrimet e shtyra tatimore, njohur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 shpërndahen si më poshtë:

	2017	2016
Aktive të shtyra tatimore:		
Pajisje	7,192	7,454
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	2,306	2,405
Totali	9,498	9,859

22. Aktive të tjera

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Inventarë	11,908	15,081
Parapagim qiraje	136	150
Parapagime për zyrat e përmbarimit	6,344	11,414
Të tjera	13,299	12,797
Totali	31,687	39,444

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

23. Hua

Shoqëria nuk ka pasur asnjë mospagim principal ose interesi apo shkelje të tjera në lidhje me huamarrjet e saj gjatë viteve të mbyllura më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

	Norma mesatare e ponderuar 2017	31 dhjetor 2017	Norma mesatare e ponderuar 2016	31 dhjetor 2016
Norma interesi fikse				
EUR	5.46%	1,871,507	5.78%	1,625,456
LEK	6.81%	632,046	7.58%	725,586
Norma interesi e ndryshueshme				
EUR	6.11%	198,965	6.11%	201,753
LEK	7.68%	475,123	8.43%	707,545
Interes i përlogaritur mbi huatë		36,092		30,825
Totali		3,213,733	-	3,291,165
Afatshkurtër		1,406,529		1,397,428
Afatgjatë		1,771,112		1,862,912
Interes i përlogaritur mbi huatë		36,092		30,825
Totali		3,213,733		3,291,165

24. Obligacioneve të emetuara

Më 16 dhjetor 2016, Këshilli Administrativ aprovoi emetimin e obligacioneve në monedhë vendase me afat mesatar. Obligacionet janë të detajara më poshtë në bazë të monedhës dhe dates së maturimit:

	Datë emetimi	Datë maturimi	No	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Obligacione të emetuara	1 mars 2017	1 mars 2020	160	80,000	-
Interesi i përlogaritur				1,867	-
Totali			160	81,867	-

Interesi i përlogaritur me date 31 Dhjetor 2017, është 1,867 mijë Lek dhe është i pagueshëm në mars 2018. Shoqëria nuk ka pasur asnjë mospagim principal ose interesi apo shkelje të tjera në lidhje me obligacionet e saj gjatë viteve të mbyllura më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

25. Grante

Më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 grantet janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Grant për zhvillimin prog. SASPO	-	1,928
Grant për zhvillimin NFT nga BFSE Holding B.V	2,988	5,745
Të tjera	8	473
Totali	2,996	8,146

Granti për zhvillimin e SASPO i marrë nga NOA Holdings N.V për zhvillimin e programit të mbledhjes së kredive është përdorur plotësisht gjatë 2017. Granti për zhvillimin e NFT i referohet grantit të marrë nga BFSE Holdings B.V për zhvillimin e procesit të Teknologjisë për NOA-n. Shoqëria ka perfituar grantet e kushtëzuara të mësipërme të njohura si të ardhura të shtyra dhe të amortizuara gjatë jetës së dobishme të aktiveve përkatëse. Lëvizjet e granteve për vitin 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	2017		2016	
	EURO	Lek '000	EURO	Lek '000
1 Janar	60,238	8,146	92,043	12,635
Shtesa	1,722	161	3,838	522
Amortizimi për vitin	(39,425)	(5,288)	(35,643)	(4,974)
Diferenca nga kurset e këmbimit	-	(23)	-	(37)
31 dhjetor	22,535	2,996	60,238	8,146

26. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
Kosto për punonjësit dhe shperblime të përllogaritura	24,498		11,993	
Çeqe të lëshuara për t'u arkëtuar	16,319		21,844	
Detyrime të tjera tatimore	10,888		15,260	
Tarifa konsulence të tjera	1,230		1,230	
Të tjera	18,234		18,380	
Totali	71,169		68,707	

27. Kapitali i paguar

Më 31 dhjetor 2017, totali i kapitalit aksionar i aprovuar i Shoqërisë përbëhet nga 73,183 aksione, i cili është paguar kapital me një vlerë nominale për aksion prej 930 lekë si më poshtë

	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016		
	Nr i aksioneve	Pronësia %	Lek	Nr i aksioneve	Pronësia %	Lek
NOA Cooperatief U.A	1	0.001%	10	1	0.001%	10
NOA Holding N.V.	73,182	99.999%	731,829	73,182	99.999%	731,829
	73,183	100.0%	731,839	73,183	100.0%	731,839

Dividendë të paguar

Asambleja e përgjithshme miratoi më 28 prill 2017 and 29 prill 2016 për të shpërndarë dividend respektivisht si më poshtë. Dividendët janë paguar plotësisht në maj 2017 dhe 2016, përkatësisht.

	2017	2016
NOA Holdings NV	68,059	65,864
NOA Cooperatief U.A	1	1
	68,060	65,865

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (Shumat në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

28. Rezervë ligjore

Dispozitat e Ligjit Tregtar kërkojnë krijimin e rezervave prej 5% të të ardhurave neto të Shoqërisë pas zbritjes së humbjeve të akumuluar nga vitet paraprake, derisa vlera e kësaj rezervë të arrijë 10% të kapitalit aksionar të Shoqërisë.

29. Palët e lidhura

Gjatë drejtimit të biznesit, Shoqëria ka hyrë në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura. Palët e lidhura, duke përfshirë kompensimin për personelin drejtues kryesor, me të cilat Shoqëria ka kryer transaksione biznesi janë si më poshtë:

	2017	2016
Detyrimet në fund të vitit		
Llogari të pagueshme për NOA Holding N.V	-	609
Transaksionet në fund të vitit		
Komisione për drejtimin për NOA Holdings N.V.	5,679	4,376
Të drejta shfrytëzimi për NOA Holdings N.V.	3,407	3,484
Shpërblimi i drejtimit të lartë dhe Anëtarët e Bordit	20,015	19,723

Shpërblimi për Drejtorët Ekzekutivë dhe Anëtarët e Bordit që përfaqësojnë personelin kryesor të drejtimit, përfshijnë pagat dhe bonusin e performancës bazuar në miratimin e Këshillit Drejtues.

30. Angazhime dhe detyrime të konstatuara.

NOA ka marrë pjesë në disa marrëveshje huaje ku huatë e marra janë siguruar duke vënë garanci huatë e saj të arkëtueshme si më poshtë:

	2017	2016
Depozita me afat	1,834,244	1,803,468
Hua dhe paradhënie klientëve	651,187	794,960
Totali	2,485,431	2,598,428

(a) Angazhime për qiratë operative

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 Shoqëria është pjesë e disa marrëveshjeve të qirasë operative lidhur me qeranë e zyrave dhe automjeteve të cilat përfundojnë në data të ndryshme. Pagesat minimale të ardhshme për marrëveshjet kryesore janë si më poshtë:

	2017	2016
Më pak se 1 vit	11,619	9,652
Totali	11,619	9,652

Shuma e shpenzimeve të qirasë operative e njohur në fitim ose humbje si shpenzim për qiratë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është 41,569 mijë Lekë (2016: 41,545 mijë Lekë) (referojuni shënimit 14).

(b) Procedura ligjore

Shoqëria është përfshirë në disa procese gjyqësore dhe procedura ligjore të cilat rrjedhin nga aktiviteti i zakonshëm i biznesit. Drejtimi mendon se këto procese nuk do të kenë efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar dhe operativ të Shoqërisë.

31. Ngjarje pas periudhës së raportimit

Gjatë vitit 2018, Shoqëria ka ndryshuar palën kontrolluese përfundimtare dhe ka njoftuar Bankën e Shqipërisë konform rregullores dhe legjislacionit në fuqi.